

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rrëfeket Adelina Ismaili. Nga kërcënimet dhe sulmet fizike te Shqipëria që e shpëtoi
ADRESA	https://piranjat.al/showbiz/rrerefet-adelina-ismaili-nga-kercenimet-dhe-et-fizike-te-shqiperia-q-i106233
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 19:19:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 19:06:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5bd817613afdb19c28ff7ee4644a6003904a3cf9caa270e0f764c0493439f561
TEKSTI	1904d220dbb369f5d85ce769a708e50cd92a751b7ab32359fd49fd2767495668
PAMJA	eaf8b5e1536aadb0bc12b851ea54b37240fb62d623090894ca350ec40b97aba8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a557a211c6e418ae7016f062bfb53f2ffecf7da16c6cf86d68dc1b894ef0fb90
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	bdb0f4977024bde548b4e3b2f30b00cf48adba46ab69ac7a79901c9e1751e8c0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a557a211c6e418ae7016f062bfb53f2ffecf7da16c6cf86d68dc1b894ef0fb90>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: 49-vjeçari i jep fund jetës në burgun e Dosit Shtetasi Agron Llapushi, ne Elbasan, bllokohet Elbasan. Për shkak të Zbardhet ngjarja ka përfunduar me të shpënë Gramshit plagosen automjete janë përplasur të ri të SHBA-ve në Shteteve të Bashkuara të Amerikës në hu

SHOWBIZ

Rrëfihet Adelina Ismaili. Nga kërcënimet dhe sulmet fizike te Shqipëria që e shpëtoi

Piranjat Përditësimi i fundit 26 Shtator 2026, 21:06



Adelina Ismaili, një prej emrave që ka shënuar skenën shqiptare për dekada, ka ardhur me një rrëfim ndryshe, larg vetëm muzikës dhe karrierës. Në një bisedë të hapur në podcastin “Pa komplekse”, nga Elion Kollçaku diva e muzikës shqiptare ka folur për feminizmin, përplasjen e saj me mentalitetin e kohës, kërcënimet që thotë se ka marrë për qëndrimet publike, familjen, raportin me Shqipërinë dhe jetën pas 40 vitesh në skenë.

Ismaili kujtoi periudhën kur fliste publikisht për të drejtat dhe lirinë e grave, në një kohë kur deklarata të tilla përballëshin me një realitet shumë më konservator. Por edhe pas kaq shumë vitesh, ajo thotë se raporti i saj me një pjesë të shoqërisë nuk ka ndryshuar aq sa mund të mendohet.

“Unë nuk kuptohem as sot, të jem e sqingertë. Kam keqkuptime shumë të mëdha me kosovarët e mi, me pjesën mashkullore të kosovarëve, edhe sot e kësaj dite”, shprehet Adelina. Sipas saj, të fliste hapur për feminizmin nuk ishte vetëm një zgjedhje artistike apo publike, por diçka që në momente të caktuara i kushtoi shumë. Ismaili rrëfen se është përballur jo vetëm me kritikë, por edhe me kërcënime, mallkime, të shara e deri në sulme fizike.

“Ka rezultuar e rrezikshme për mua. Ju nuk mund ta besoni se sa larg janë njerëzit në gjendje të shkojnë. Po flas për kërcënime, po flas për mallkime, po flas për të shara deri te sulmet fizike”, tregon ajo.

Adelina vijon të mbrojtë bindjen se liria e gruas është një nga themelet e zhvillimit të shoqërisë. Madje, në një prej deklaratave më të forta të intervistës, këngëtarja shprehet se bota do të ishte ndryshe nëse gratë do të kishin më shumë pushtet.

“Sikur gratë ta udhëheqnin botën, nuk do të kishim kurrë luftra. Kjo tingëllon si shaka, por unë besoj që është e vërtetë. Besoj që shpëtimi i botës do të vinte nga matriarkati”, thotë Ismaili.

Një tjetër moment i fortë të rrëfimit është raporti i saj me Shqipërinë. Pas katër dekadash karrierë, Adelina pranon se pikërisht Shqipëria ka pasur një rol të veçantë në rrugëtimin e saj profesional. Ajo thotë se këtu është përqafuar si artiste më shumë sesa në Kosovë.

“Të jemi të sqingertë, atje jam përqafuar si artiste shumë më shumë sesa në Kosovë. Gjithmonë them që Shqipëria më ka shpëtuar artistikisht, profesionalisht. E them këtë sepse është e vërtetë”, shprehet këngëtarja.

Ismaili ndalet edhe te imazhi që e ka shoqëruar gjatë gjithë karrierës. Performancat e saj, veçanërisht në fillimet e rrugëtimit artistik, shpesh u konsideruan provokuese. Sot ajo këmbëngul se pas tyre nuk qëndronte dëshira për të banalizuar skenën, por një mesazh i menduar.

“Unë nuk kam qenë banale kurrë. Pa thellësinë e mendimit, pa thellësinë e veprimit, unë as nuk ia kam mësyrë skenës. Çdo detaj ka qenë i planifikuar dhe i menduar në funksion të një kauze”, thotë ajo.

Pikërisht këtu Adelina bëhet kritike edhe ndaj një pjese të artit të sotëm. Për të, një artist nuk mund të jetë thjesht një person që performon, por duhet të ketë identitet, karakter dhe diçka për të thënë. “Nëse nuk ka shpirt në atë që e bën, të lutem lëre, se dëmton”, shprehet Ismaili, duke theksuar se arti pa kauzë dhe pa qëndrime humbet thelbin e tij.

Në rrëfimin e saj nuk mungon as nëna, Mona, një nga njerëzit më të rëndësishëm në jetën dhe karrierën e Adelina. Këngëtarja pranon pa hezitim se pa të nuk do të ishte personazhi që publiku njeh sot. Mona, sipas saj, arriti të ndërthurte rolin e nënës me atë të menaxheres, duke u bërë një nga shtyllat e rrugëtimin të saj profesional.

“Ajo i ka ndërthurur aq bukur rolin e saj si nënë dhe profesionin e saj si menaxhere e imja, sa që nuk di ta ketë bërë dikush në botë si ajo”, rrëfen Adelina.

Ndërsa për bashkëshortin, Valin, Ismaili përdor një përkufizim të drejtpërdrejtë: “dashuria e jetës time”. Ajo tregon se këtë vit bëjnë 18 vite bashkë dhe vlerëson mbi të gjitha qëndrueshmërinë e tij, si në jetën personale, ashtu edhe në atë profesionale.

Pas 40 vitesh karrierë, Adelina Ismaili nuk e sheh rrugëtimin e saj si diçka që po shkon drejt fundit. Përkundrazi, filozofia e saj mbetet e njëjtë: fundet janë vetëm fillime të reja.

Dhe ndoshta pikërisht kjo shpjegon edhe Adelina të sotme: një artiste që, pas katër dekadash në skenë, vazhdon të flasë me të njëjtën gjuhë të drejtpërdrejtë për lirinë, gratë, artin, familjen dhe shoqërinë, edhe kur qëndrimet e saj vazhdojnë të shkaktojnë debat.

Artikuj te sugjeruar

SHOWBIZ 26 Shtator18:51

[“Nuk mësohesh kurrë me këtë humbje”/ Odeta Gjevori rrëfen dhimbjen pas humbjes së bashkëshortit](#)

Gazetarja e njohur Odeta Gjevori ka ndarë një nga rrëfimet më personale, ku ka folur për një prej periudhave më të vështura...

SHOWBIZ 26 Shtator18:05

["Rikthimi lidhet me shumë arsye"/ Princi Harry kthehet në Britani: Fëmijët janë të lumtur në shkollë](#)

Princi Harry ka shprehur kënaqësinë për rikthimin e tij në Mbretërinë e Bashkuar, pas gjashtë vitesh jetese në Kaliforni...

SHOWBIZ 26 Shtator17:40

[Hyseni "fikte" radarët për Agasin, këngëtarja ironizon: Vlera dëshmoi që të jesh k*çkë mund të jesh shëmtirë dhe me post drejtues](#)

Fikja e radarëve të shtetit nga Vlera Hyseni për Ergys Agasin prej ditës së djeshme është vënë në qendër...

SHOWBIZ 26 Shtator16:31

[A vazhdon të jetë i virgjër? At Nikolla Xhufka tregon si vepron kur përballet me tundimet seksuale](#)

At Nikolla Xhufka ka qenë i ftuar në emisionin “She’s On Air”, ku është vendosur përballë pyetjeve pikante të...

SHOWBIZ 26 Shtator16:24

[Vizita e Dua Lipës në Pejë surprizë për të ftuarit! Këngëtarja merr pjesë në dasmën familjare në mesin e traditave kosovare](#)

Këngëtarja shqiptare me famë botërore, Dua Lipa, është shfaqur së fundmi në një vizitë në Pejë duke...

SHOWBIZ 26 Shtator16:19

[Marina Vjollca shkëlqen në Milano Fashion Week, e shoqëruar nga Ghetto Geasy në sfilatën e Elisabetta Franchi](#)

Milano Fashion Week ka mbledhur emra të njohur të modës dhe showbiz-it ndërkombëtar, mes të cilëve këtë herë i...

SHOWBIZ 26 Shtator15:31

[Gruaja që akuzoi Jay-Z për sulm seksual tërheq akuzat? “Nuk e kam takuar kurrë”](#)

Gruaja që në vitin 2024 akuzoi Jay-Z për përdhunim ka tërhequr zyrtarisht pretendimet e saj, duke deklaruar në një dokument...

SHOWBIZ 26 Shtator15:23

[Probleme të reja për Ed Sheeran, anulohen dy koncerte? Ja arsyeja](#)

Ed Sheeran është përballur me një tjetër pengesë gjatë turneut të tij “Loop”, pasi dy koncertet e planifik...

SHOWBIZ 25 Shtator22:58

[FOTO/Një dasmë si në filma! Damiano David dhe Dove Cameron i thonë “Po” njëri-tjetrit në zemër të Toskanës](#)

Damiano David, ish-frontmeni i Måneskin, dhe këngëtarja e aktorja amerikane Dove Cameron i kanë dhënë fund beqarisë në...

SHOWBIZ 25 Shtator20:30

[Pak ditë pas humbjes së të vëllait, modelja e njohur përjeton një tjetër moment ankthi](#)

Pak ditë pas vdekjes tragjike të vëllait të saj, Presley Gerber, modelja dhe aktorja Kaia Gerber është përballur me një...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 26 Shtator

[E TRISHTË/ Këta janë Flori dhe Florida, vëlla e...](#)

Personat që shihni në foto janë Flori dhe Florida Hoxha, motër e vëlla, të cilët humbën jetën tragjikisht pas shp...

AKTUALITET 26 Shtator

[Aksioni i SPAK kundër grupit Rraja/ Shkon në 17...](#)

Të dhëna të reja kanë dalë në dritë lidhur me operacionin e koduar “Muri i Lartë”, ku hetimet e ndjekura n...

AKTUALITET 25 Shtator

Zbardhet lista/ 44 restaurantet ku u tregtua dja...

Pas alarmit të dhënë për hyrjen në Shqipëri të një loti të kontaminuar djathi "Brie" nga Italia, zbardhet nga media...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2





PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!





Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.